



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
Sektori i Sekretari-Arkivit

Model nr.5

KARTELESHOQERUESE E PRAKTIKES

Dergues Profekti i Qarkut, Gier
06.03.2020

Nr. Prot. 249 Data

Shkurtimi i lendes Kohim Përgjigje

Per trajtim nga:	
(struktura te tjera te ngarkuara)	<u>Sh. Enke Felo</u>
Me porosi:	<u>Sh. Anil do Hydren</u>

Afati: Normal 7dite) Prioritet:3dite) Urgjent:(brenda dites) P/afat/per dijeni) Tjeter: ___ dite

Data 09.03.20 Nr. Prot. 1147/1

Nenshkrimi: (TITULLARI)

Marre ne dorezim: _____

Nenshkrimi

Kalon per trajtim (struktura): _____

Me porosine: _____

Marre ne dorezim: _____

Nenshkrimi

Kalon per trajtim (struktura): _____

Me porosine: _____

Marre ne dorezim: _____

Nenshkrimi

Kalon per trajtim Specialistit: _____

Me porosine: _____

Trajtimi i materialit perfunduar me: _____

Specialisti

Trajtimi i materialit pranuar me: _____

Eprori ne shkalle hierarkike

Trajtimi i materialit miratuar me: _____

Eprori ne shkalle hierarkike

Trajtimi i materialit miratuar me: _____

Eprori ne shkalle hierarkike



REPUBLIKA E SHQIPERISË
PREFEKTI QARKU FIER

Nr. 249 Prot.

Fier, më 06.03.2020

Lënda: Kthim përgjigje për ligjshmërinë e vendimeve 10-15 të Këshillit Bashkiak Roskovec.

Drejtuar: Znj. Majlinda BUFI
KRYETAR I BASHKISË ROSKOVEC.

Z. Kadri HYSKA
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK ROSKOVEC.

ROSKOVEC

Në përgjigje të shkresës suaj me Nr. 1147 prot. datë 27.02.2020 protokolluar në institucion e Prefektit të Qarkut Fier me Nr.249 Prot. datë 02.03.2020 bazuar në Ligjin nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” neni 16, shqyrtoam vendimet e Këshillit Bashkiak Roskovec të marra në mbledhjen e datës 24.02.2020 si dhe dokumentacionin plotësues për vendimet si më poshtë:

Vendimi Nr. 10 datë 24.02.2020 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhen 1-31 Janar 2020” Është në përputhje me Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8 pika 2, 9, 24; Ligjin Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21; VKM Nr. 597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” Kreu i IV pika 2 dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.5 datë 17.2.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6%” (i ndryshuar).

Vendimi Nr. 11 datë 24.02.2020 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Roskovec”

Është në përputhje me Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8 pika 2, neni 9 pika 1 paragrafi 1.1 shkronja “b”, neni 23 pika 14, Ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” (i ndryshuar) neni 5 pika 1.3 shkronja “a”, neni 12 pika 2 shkronja “b”, neni 15 pika 1.2.2, VKM Nr.686 Datë 22.11.2018 “Për miratimin rregullores së planifikimit të territorit” neni 4, neni 8, neni 9, neni 61.

Vendimi Nr. 12 datë 24.02.2020 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për miratimin e raportit për vlerësimin dhe parashikimin afatmesëm të të ardhurave 2021-2023”

Është në përputhje me me Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8 pika 2, ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 34 si dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.03 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”.

Vendimi Nr. 13 datë 24.02.2020 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për anulim të Vendimit nr.9 datë 24/01/2020 “Për një ndryshim në listën e inventarit, miratuar me VKM Nr.770 date 24/09/2010 “Per miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Roskovec Qarku Fier”
Është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore” neni 8 pika 2 si dhe “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” neni 113.

Vendimi Nr. 14 datë 24.02.2020 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për rishqyrtimin e Vendimit te Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr.8 date 24/01/2020 “Për një shtesë në listën e inventarit, miratuar me VKM nr. 1210 datë 11/12/2009 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Kuman të Qarkut të Fierit”

Është në përputhje me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 9 pika 1.2 shkronjat “a” dhe “c”; neni 54; si dhe në zbatim të Ligjit Nr.8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar).

Vendimi Nr. 15 datë 24.02.2020 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për miratim dhe transferim fondesh në Buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2020”

Është në përputhje me Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 24, Ligjin Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 20 pika 1, neni 45, Ligjin Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin në sistemin buxhetor në RSH” (i ndryshuar), Ligjin Nr.22/2018 “Për strehimin social” neni 67 shkronja “b”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.9 datë 20.03.2019 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Baki BALAJ

